



Republika e Kosoves
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Dragash
Opština Dragaš
Municipality Dragas

-Kuvendi Komunal

01. Nr.06-12411/1

Dt.28.07.2016

D r a g a s h

Në bazë të nenit 13. dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 2.3. dhe 4. të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtëshme (Ligji 03/L-139) dhe neneve 32.2. dhe 57 të Statutit të Komunës Dragash, Kërkesës së N P N -SH.P.K „RENELUAL TAHIRI“ nga Prizreni 01 Nr.463-5568 të dt.08.04.2016, Kuvendi Komunal i Dragashit, konform Kërkesës së Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, për rishqyrtim të ligjshmërisë, 02 Nr.2513-2/16 të dt.20.07.2016, në seancën e mbajtur të dt.28.07.2016, miraton këtë:

V E N D I M

- I. **LEJOHET** shqyrtimi i mëtejshëm i Kërkesës për shpronësim për qëllime të interesit publik të sipërfaqeve të pronave të parcelave-pjesëve të paluajtëshme private për ndërtimin e dy mini-hirocentraleve dhe atë në HC“ORÇUSHA“ me kapacitet 4MW dhe HC“DRAGASH“ me kapacitet 3,4MW, që si parcela janë të përcaktuara për përfshirje në Projektin, siç qëndron në Listë-Tabelën, në vijim.
- II. Vlerësimin e pronave të paluajtëshme e bënë organi shpronësues në nivel vendi-Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtëshme në kuadër të Departamentit të Tatimit në Pronë të Ministrisë së Financave-Prishtinë.
- III. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Shërbimi Pronësoro-Juridik (DUGJMM) dhe Drejtoria i Bujqësisë, Pylltarisë, Zhvillimit Rural dhe Inspektionit i Komunës-Dragash, kurse kompenzimin për shpronësim e siguron investuesi NPN-SHPK „Renelual Tahiri“-Prizren.
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit.

A r s y e t i m

Duke u bazuar në Kërkesën e MAPL-së (MMPH-së) për rishqyrtimin e Vendimit të KK-së Dragash të dt.28.04.2016, Komuna e Dragashit ka marr veprime konkrete sipas dispozitave ligjore në fuqi, përkatësisht ndryshimit të pikës II të dispozitivit të Vendimit, duke vendosur në seancën e dt.28.07.2016, si në dispozitiv.

Shtojcë:Kërkesa e NPN-SHPK „Renelual Tahiri“-Prizren dhe Lista-Tabela e pronave për shpronësim.

I dërgohet:

- MAPL-së (Zyrës Ligjore)-Prishtinë,
- Kryetarit të Komunës-Dragash,
- Drejtoratit të Urbanizmit, Gjeodezisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit-Dragash,
- Drejtoratit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Inspektion-Dragash, dhe
- Arkivit



Kuvendi Komunal-Dragash

Kryesuesi

Shaban/Shabani